



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201701610/4

Tiranë ___/___/2017

Lënda: Rekomandohet "Marrja e masave për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të kërkesave të të dënuarve për dhënien e lejës shpërblyese ose të veçantë, shërbim shëndetësor të vazhdueshëm dhe me cilësi, si dhe respektimin e afateve të kërkuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit për kthimin e përgjigjeve të shkresave "kërkesë për shpjegime apo informacion".

Drejtuar : Z.Arben ÇUKO
Drejtor

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

TIRANË

I nderuar Z.ÇUKO,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2017, një numer i konsiderueshëm i të dënuarve kanë ngritur shqetësime nëpërmjet ankesave të tyre, kryesisht për mosdhënie apo vonesa në dhënien e lejës shpërblyese, në mosndjekje në vazhdimësi apo mosdhënie të ndihmës mjekësore etj.

Gjatë trajtimit të ankesave të dënuarve, konstatohet se drejtoritë e I.E.V.Penale nuk janë korrektë në kthimin e përgjigjeve të shkresave të Institucionit të Avokatit të Popullit, brënda afatit ligjor të kërkuar. Në raste të tjera ato janë të përcipta dhe të pa argumentuara në mënyrë bindëse dhe ligjore, e për rrjedhojë të dënuarit i janë drejtuar përsëri me ankesë Institucionit të Avokatit të Popullit, apo komunikuar me anë të telefonit, duke dhënë prapësime, pasi përgjigjet e institucionit sipas tyre kanë qënë të njëanshme.

E përmëdim këtë shqetësim, pasi në nenin 19 gërmat"b" dhe "ç" të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar thuhet: "Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura Avokati i Popullit ka të drejtë : *b.të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin ç.Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme*".

Prandaj, do të kërkonim që nga administrata e I.E.V.Penale të bëhet vlerësimi i shkresave tona dhe kthimi i përgjigjeve të jetë bindës dhe i argumentuar në mënyrë ligjore, sipas

natyrës së ankesës së të dënuarit. Me po këtë përgjegjësi duhet të kthehet dhe përgjigja brënda afatit të kërkuar në shkresë.

Trajtimi dhe ndjekja e shpejtë e procedurave për ankesat e të dënuarve, jo vetëm do të zgjidhte shqetësimet e tyre, por dhe do të minimizojë përsëritjen. Në këtë drejtim një rol pozitiv duhet të luajnë dhe punonjësit e sektorit juridik në çdo institucion, duke komunikuar dhe sqaruar nga afër dhe me durim ankuesit.

Ankesat e të dënuarve në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

Së pari: Për mosndjekje apo zvarritje të procedurave për dhënien e lejës shpërblyese të dënuarve, pas paraqitjes së kërkesës së tyre.

Të tilla mund të përmenden rasti i ankesës së të dënuarit G.XH., nga I.E.V.Penale Fier, N.C., nga I.E.V.Penale Drenovë Korçë etj. Ndërsa ankesa e të dënuarit T.B., nga I.E.V.Penale Fier është për zvarritje të procedurave për dhënien e lejës së veçantë pas lindjes së fëmijës nga bashkëshortja e tij.

Sipas ankuesve ndonëse ata kanë paraqitur kërkesë në administratën e institucionit, nuk kanë marrë përgjigje zyrtare me shkrim, por nga punonjës të saj janë informuar se “*po vonohej përgjigja nga Komisariati i Policisë*”, “*se lejët shpërblyese ishin pezulluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve*”. Në raste të tjera të dënuarit kanë pretenduar për dhënie të lejës shpërblyese në mënyrë selektive.

Zgjidhja më e mirë dhe ligjore e këtij shqetësimi do të ishin njohja e të dënuarve me rregullat dhe kriteret për përfitimin e lejës shpërblyese, dhe konkretisht nenit 59 paragrafi i parë i ligjit nr.40 datë 17.04.2014, ku thuhet: “*Të dënuarit, të cilët respektojnë rregullat e disiplinës dhe rregulloren e brendshme të institucionit, që janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të riintegritimit dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, kanë të drejtë të marrin lejë shpërblyese, por jo më shumë se 20 ditë në vit*”.

Ndërsa në paragrafin e pestë të nenit 59 thuhet: “*Brënda 7 ditëve nga marrja e kërkesës për lejë, institucioni ku kryhet dënimi miraton lejën shpërblyese. Koha e dhënies së lejës përcaktohet sipas një grafiku të miratuar nga drejtori i institucionit që në fillim të vitit*”.

Po ashtu, institucioni duhet të njohë të dënuarin për rrugët që ata duhet të ndjekë në rast refuzimi të kërkesës për lejë shpërblyese ose të veçantë, e parashikuar në paragrafin e shtatë të nenit 59, ku thuhet: “*Në rast refuzimi të dhënies së lejës, i dënuari ose përfaqësuesi i tij ligjor ka të drejtë të bëjë ankim pranë Ministrit të Drejtësisë, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative brënda pesë ditëve, dhe më pas ka të drejtë të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për lejë*”.

Protokollimi i kërkesës për lejë e të dënuarit në sekretarinë e institucionit, shqyrtimi i saj dhe kthimi i përgjigjes brënda 7 ditëve, janë zgjidhja korrekte dhe më e mirë e ankesave të të dënuarve. Mandej, transparenca dhe vënia në dispozicion e dokumenteve eventuale të dënuarit, në rast refuzimi të lejës shpërblyese, janë domosdoshmëri për një proces të rregullt ligjor në rast ankimit në gjykatë.

Së dyti: Në mosndjekjen në vazhdimësi dhe mosmarrjen e masave për ndihmë mjekësore të dënuarve me probleme shëndetësore.

I tillë është rasti i ankesave të shtetasve A.K. dhe SH.Ç., të cilët vuajnë dënimin në I.E.V.Penale “Shënkoll” Lezhë etj. I dënuari SH.Ç., ka ngritur shqetësimin se për mungesë mjete transporti është vonuar transferimi i tij nga Institucioni i Veçantë Shëndetësor i Burgjeve Tiranë në I.E.V.Penale Lezhë, pasi mjekët kishin dhënë miratimin për përfundimin e shërbimit mjekësor në atë institucion.

I dënuari S.K., nga I.V.SH.Burgjeve Tiranë, ankohet ndaj shërbimit stomatologjik për mungesë të bazës materiale, për të cilin kemi paraqitur dhe një rekomandim.

Ankesa e të dënuarit M.RR., nga I.E.V.Penale Fushë Krujë, për zvarritje të procedurave për ndërhyrje mjekësore në një klinikë stomatologjike jashtë sistemit të burgjeve; ankesa e të dënuarit K.L., nga I.E.V.Penale “Zahari” Krujë, për ndryshim terapie lidhur me trajtimin mjekësor si person me probleme të shëndetit mendor dhe ankesa e të dënuarit SH.K., i cili vuan dënimin në I.E.V.Penale Peqin, për vizitë të specializuar tek mjeku O.R.L.

Në dispozitat ligjore për trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, aktet nënëligjore të nxjerra për këtë qëllim dhe aktet ndërkombëtare, përcaktohen qartë detyrimi i sigurimit të shërbimit mjekësor gjatë gjithë kohës së qëndrimit të të dënuarve në institucion, pavarësisht nga kërkesat e tyre. Është administrata e institucionit ajo që siguron, kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve.

Të drejtat e të dënuarve për trajtim në shërbimin shëndetësor parashikohen dhe në aktet ndërkombëtare. Kështu, në Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Jashtëm të Këshillit të Europës datë 12 Shkurt 1987 “Për Rregullat Europiane të Burgut”, ku në kapitullin që bën fjalë për Drejtimin e Sistemit të Burgjeve, në pikën 29 thuhet: “Mjeku do të vizitojë dhe ekzaminojë secilin të burgosur menjëherë pas pranimit dhe më vonë sa herë të jetë e nevojshme, në mënyrë të veçantë për të zbuluar sëmundje fizike ose mendore dhe për të marrë të gjitha masat e nevojshme për trajtimin mjekësor...” kurse në Pikën 30.1 thuhet: “Mjeku do të kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të burgosurve dhe në përputhje me kushtet e intervalet e standarteve spitalore, do të vizitojë të gjithë të burgosurit e sëmurë, të gjithë ata që raportojnë për sëmundje, ose dëmtim dhe çdo të burgosuri t’i kushtohet një vëmendje e veçantë”.

Është detyra e personelit mjekësor të Shërbimit Shëndetësor në I.E.V.Penale të vëndit që të verifikojnë dhe evidentojnë raste të tjera të mundshme të kërkesave të dënuarve që paraqiten me probleme të ndryshme të shëndetit, apo dhe probleme të shëndetit mendor, duke marrë të gjitha masat e nevojshme për trajtimin mjekësor të tyre.

Ndjekja në vazhdimësi e të dënuarve nga stafi mjekësor dhe ai psikosocial do të jetë një barrierë e fortë për të parandaluar rastet e shkaktimit të vetvrasjeve si ai i muajit Prill 2017, me pasojë vdekjen e të dënuarit A.L., dhe në muajin Nëntor 2017, i të dënuarit F.K.

Së treti: Në mosmarrjen e masave për dërgimin e të dënuarit në dhomën e paraburgimit, pas mbarimit të afatit të masës disiplinore, të veçimit.

E tillë është ankesa e të dënuarit G.V., i cili vuan dënimin në I.E.V.Penale “Shënkoll” Lezhë. Me urdhërin nr.278 datë 10.05.2017, drejtorja e atij institucioni ka marrë masë disiplinore ndaj tij me 20 ditë përjashtim nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta (veçim), pasi gjatë kontrollit të ushtruar në dhomë i është gjetur një shishe plastike 100 ml, e dyshuar me pije alkoolike. Ndonëse më datë 30.05.2017, kishte mbaruar afati i masës disiplinore, i dënuari është mbajtur në atë dhomë deri më datë 14.06.2017, “për arsye mospërshtatshmërie”.

Të njëjtin shqetësim ka ngritur dhe i dënuari SH.D., nga I.E.V.Penale Vaqarr, pasi është mbajtur në dhomën e veçimit tej afatit të masës disiplinore të dhënë nga Komisioni Disiplinor i institucionit.

Së katërti: Në krijimin e kushteve për plotësimin e kërkesave të të dënuarve për të siguruar avokat mbrojtës të caktuar nga shtetit, me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre në gjyq.

I tillë është rasti i ankesës së të dënuarit G.T., i cili vuan dënimin në I.E.V.Penale Rrrogozhinë etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit për këto raste të dënuarit i ka orientuar që të paraqesin kërkesë me shkrim në Komisionin Shtetëror të Ndihmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën të pasqyrojnë gjëndjen ekonomike financiare të familjes, gjëndjen familjare si dhe llojin e ndihmës juridike që kërkojnë.

Do të sugjerohet që nga juristët e sektorit juridik në I.E.V.Penale, të krijohen mundësitë e ofrimit të ndihmës juridike të dënuarve, siç mund të jetë dhe përpilimi i kërkesës, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të bashkëpunojë me drejtorinë përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë për realizimin e kësaj të drejte ligjore.

Për konstatimet e paraqitura më lart, lutemi të analizohen me punonjësit e administratës së I.E.V.Penale, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e punës . Në moton e veprimtarisë së punës të punonjësve të I.E.V.Penale, duhet të prevalojë respektimi dhe zbatimi i të drejtave dhe lirive themelore të të dënuarve.

Për sa sipër bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”* me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, paraqet rekomandime për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

REKOMANDOHET

“Marrja e masave të nevojshme për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të kërkesave të të dënuarve për lejë shpërblyese ose të veçantë, shërbim mjekësor të vazhdueshëm dhe me cilësi, si dhe respektimin e afateve të kërkuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit në kthimin e përgjigjeve të shkresave “kërkesë për shpjegime, apo informacion”.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit *“Për Avokatin e Popullit”*.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI